



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:034180
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05458977

C.nr.199/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Blerina KURTAJ, dhe me bashkëpunëtoren profesionale Ardiana Nikollbibaj Thaqi, në çështjen juridike – kontestimore të paditësit A.H., nga Gjakova, rr. "...", nr.10, kundër të paditurve NPT “.. SH.P.K. Gjakovë, të cilën e përfaqësojnë E.B., nga Gjakova, rr. "...", nr.5 dhe L.K., nga Gjakova, rr. "...", nr.17 dhe ProCredit Bank, nga Prishtina, rr. "...” nr.26, me objekt kontesti: vërtetim pronësie, vlera e kontestit 5.000.oo Euro, jashtë seancës, me 15 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET procedura kontestimore e udhëhequr sipas shenjës C.nr.199/21, për shkak të vdekjes së përfaqësuesit të parë - të paditurit L.K., ish nga Gjakova.

A r s y e t i m

Paditësi A.H., nga Gjakova, rr. “.. nr.10, me datë 23.02.2021 ka parashtruar padi E.b., nga Gjakova, rr. "...”, nr.5 dhe L.K./nga Gjakova, rr. "...”, nr.17 dhe ProCredit Bank, nga Prishtina, rr. "...” nr.26, për vërtetim pronësie.

Gjykata është njoftuar se përfaqësuesi i të paditurit të parë L.K. ka vdekur e këtë fakt e vërtetoj përmes certifikatës së vdekjes me numër reference 2/2022RV/2001, numër rendor 396, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, me datë 12.02.2024.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 277 pika (a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilin është paraparë se: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqës vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim*”, vendosi që ta ndërpres

procedurën kontestimore në këtë çështje juridike kontestimore, ndërsa e njëjta do të vazhdoj kur trashëgimtarët e paditësit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

Andaj gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.199/21, me 15 mars 2024

GJ Y Q T A R J A

Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Numri i lëndës: 2021:034180
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05458977